



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MARRËVESHJE

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Sot, më datë, 20.06.2018, Palët e mëposhtme:

Këshilli Kombëtar i Territorit, përfaqësuar nga Kryeministri dhe Kryetari i KKT
Z. Edi Rama

dhe

Bashkia Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Erion Veliaj

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit Nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përçaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar dhe Lejes Zhvillimore të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr.09, datë 20.06.2018, për objektin: “Objekt banimi dhe shërbime “Tirana’s Rock”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”, bien dakord si më poshtë:

NENI 1
OBJEKTI

- 1.1 Objekti i kësaj marrëveshje është delegimi i kompetencave Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave përkatëse ligjore, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në lidhje me ndërtimin e objektit: “Objekt banimi dhe shërbime “Tirana’s Rock”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”, me



subjekt zhvillues shoqërinë “ANA” sh.p.k., sipas Lejes Zhvillimore përkatëse, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.09, datë 20.06.2018.

NENI 2 KOHËZGJATJA

- 2.1 Kompetencat objekt i kësaj Marrëveshjeje do të ushtrohen nga Bashkia Tiranë, nga data e paraqitjes së aplikimit fillestar të subjektit zhvillues për Leje Ndërtimi, deri në datën e lëshimit të Çertifikatës së Përdorimit.

NENI 3 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

- 3.1 Këshilli Kombëtar i Territorit ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
- i. Vënien në dispozicion të Bashkisë Tiranë të Lejes së Zhvillimit të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.09, datë 20.06.2018, për objektin: “Objekt banimi dhe shërbime “Tirana’s Rock”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “ANA” sh.p.k.;
- dhe
- ii. Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, që shoqëron këtë Vendim.
- 3.2 Bashkia Tiranë ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
- i. Kryerjen e të gjitha procedurave administrative/ligjore, sipas përcaktimeve të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, për objektin: “Objekt banimi dhe shërbime “Tirana’s Rock”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “ANA” sh.p.k.;
 - ii. Shqyrtimin, verifikimin dhe vlerësimin e dokumentacionit përkatës teknik; të dokumenteve që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në këtë zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta, si dhe të çdo akti/dokumenti tjetër



ligjor, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

- iii. Miratimin dhe lëshimin e akteve/dokumenteve të poshtëshënuara, për objektin: “Objekt banimi dhe shërbime “Tirana’s Rock”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “ANA” sh.p.k., sipas Lejes Zhvillimore përkatëse, të miratuar me vendimin e KKT-së Nr.09, datë 20.06.2018:
- Leje Ndërtimi;
 - Certifikatë Përdorimi.

NENI 4 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 4.1 Palët do t’i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje me mirëkuptim ndërmjet tyre.

NENI 5 GJUHA E MARRËVESHJES

- 5.1 Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë.

NENI 6 EFEKTET JURIDIKE DHE PUBLIKIMI

- 6.1 Palët bien dakord se efektet juridike të kësaj Marrëveshjeje do të fillojnë në momentin e nënshkrimit të saj.
- 6.2 Kjo Marrëveshje publikohet në Fletoren Zyrtare.

PALËT

KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

Përfaqësuar nga,
Z. EDI RAMA



BASHKIA TIRANË

Përfaqësuar nga,
Z. ERION VELIAJ

